



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOERCIALE E KOSOVËS**

---

Numri i lëndës: 2021:223202  
Datë: 26.11.2024  
Numri i dokumentit: 06505911

**K.DH.SH.II.nr.1454/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në Rr. ”Bill Klintoni”, p.nr. në Prishtinë, kundër debitorit Kid Zonë Kosova me pronar F.A., nga Prishtina, me adresë rr. Zona Industriale Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Prishtinë- Departamenti i Përgjithshem PPP.nr.506/19 të datës 20.05.2019, me datën 25.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në me seli në Rr. ”Bill Klintoni”, në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.506/19 të datës 20.05.2019, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore ne Prishtinë- Departamenti i Përgjithshem, me aktvendimin e ankimuar. PPP.nr. PPP.nr.506/19 të datës 20.05.2019, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Kid Zonë Kosova, me adresë rr. Zona Industriale Prishtinë, ashtu që Urdhri

Përmbarrimor P.nr. 410/19, i lejuar më datë 20.02.2019, nga Përmbarruesi Privat Flamur Bogaj, SHFUQIZOHET.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori përmes përgjigje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet në tërësi ankesa e kreditorit dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 506/19 i datës 20.05.2019 të vërtetohet

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

**- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, P.nr.410/19 të datës 20.02.2019, me të cilin ka lejuar përmbarrimin, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, faturës me numër 127883 duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit borxhin prej 1290.75 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore nën kërcnimit të përmabrrimit privat.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (në tekstin e mëtejshëm: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, për shkak të si në vijim: Sipas nenit 29 par 1.2 të LPP-se paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, "ekstraktet e verifikuara nga librat afarist per

pagesat e shërbimëve komunale të furnizimit me uji, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave “sepse ne rastin konkret faturat nga librat afarist lëshohen për vetëm për subjekte të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale për shërbimet e caktuara. Andaj gjykata e shkallës së parë në rastin konkret vlerëson se faturat të cilat janë lëshuar për periudhën 10.01.2018 e deri me datë nuk kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale mese veti. Gjykata e shkallës së parë duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 29 par 1.2 të LPP-së. Andaj, si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet nga neni 29 i LPP-së. Andaj, duke qenë se urdhri përmbartimor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbartimor. Tutje vlerëson se të metat e theksuara si më lartë kanë mundur të evitohen nga organi përmbartues, përkatësisht nga përmbartuesi privat, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së,

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se subjektet në fjale nuk kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale për shërbimet e caktuara për periudhën në bazë të cilave është lëshuar urdhri përmbartimor. Andaj ky urdhër nuk i plotëson kushtet për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm nga neni 29 par 1.2 të LPP-së.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë

çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar.

Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II nr.1454/24, me datë 25.11.2024**

**Gjyqtari,**

**Faton Bajrami**